

Agon Topxhiu është Specialist i Validimit të Riskut në ProCredit Bank në Kosovë. Ka punuar si hulumtues në Leibniz Centre for European Economic Research (ZEW) në Mannheim të Gjermanisë dhe si Data Scientist për International Advisory Products and Systems (i-APS). Ka fituar titullin Master i Shkencës në Ekonomiks në Universitetin e Heidelbergut në Gjermani ku ka studiuar me bursë të plotë nga Fondacioni KAS - Konrad Adenauer Stiftung. Ndërkaq studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Është autor dhe bashkëautor i disa publikimeve shkencore në fushën e ekonomiksit si dhe është angazhuar në digjitalizimin e arsimit përmes projektit EdSpot.